VENDIM
Nr.166, datë 26.2.2008

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NËNKRYETARIT DHE TË SEKRETARIT SHKENCOR TË KRYESISË SË PËRKOHSHME TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr.9853, datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gudar Beqiraj emërohet nënkryetar i kryesisë së përkohshme të Akademisë së Shkencave.
2. Z. Jani Thomai emërohet sekretar shkencor i kryesisë së përkohshme të Akademisë së Shkencave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha